

Draft Laws

November 2021



pwc



Albania – Draft Laws

November 2021

Proposal of the draft law “On some additions to law no. 9975, dated 28.7.2008 ‘On National Taxes’, amended”

In Article 3, "Types of national taxes" and Article 4 "Level of national taxes", the following points are added:

12. Tax on powder milk for trade, in the amount of 100 ALL per kg.
13. Tax on the homogenized barista drink in the amount of 16 ALL per liter.
14. Tax on milk whey in the amount of 150 ALL per kg.
15. Tax on milk cream in the amount of 150 ALL per liter.
16. Tax on fuel in customs free zones and customs warehouses used for the supply of vessels for tourist and entertainment purposes. The tax on fuel in the customs free zones and customs warehouses used for the supply of vessels for tourist and entertainment purposes is 65 ALL/liter.

The production factories with a label approved by the National Food Authority are excluded from the payment of the tax on powdered milk, the tax on whey and the tax on milk cream.

Proposal of the draft law “On some additions to law no. 92/2014, ‘On Value Added Tax in the Republic of Albania’, amended”

In article 49 "Reduced rates", point 10 is added:
10. The reduced rate of value added tax, which is applied to the supply of agricultural inputs, such as chemical fertilizers, pesticides, seeds and seedlings, in addition to hormones classified in codes 2937 of the Combined Nomenclature of Goods, is 10 percent. These inputs no longer belong to the zero VAT rate (List of goods excluded from VAT in article. 51).

In Article 56 "Special Exemptions on Import", the Import of machinery and equipment, in function of the realization of investment contracts with a value equal to or higher than 500 million ALL (previously 50 million ALL) is excluded from VAT.

Furthermore, the import of machinery from the subject of simplified profit tax is repealed from the list of excluded from VAT imports.

In Article 148 "Compensation rate of agricultural producers", The compensation rate of agricultural producers is now 0 percent. (replaced to 0 percent from previously 6 percent).

Nëntor 2021

Propozimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 ‘Për Taksat Kombëtare’, i ndryshuar”

Në nenin 3, “Llojet e taksave kombëtare” dhe në nenin 4, “Niveli i taksave kombëtare” shtohen pikat:

12. Taksë për qumështin pluhur për tregti, në vlerën 100 lekë për kg.
13. Taksë për pijen e homogjenizuar barista në vlerën 16 lekë për litër.
14. Taksë për hirrë qumështi në vlerën 150 lekë për kg.
15. Taksë për krem qumështi në vlerën 150 lekë për litër.
16. Taksë për karburantin në zonat e lira doganore dhe magazinat doganore që përdoret për furnizimin e mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, në vlerën 65 lekë/litër.

Fabrikat e prodhimit me etiketë të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit përjashtohen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hirrë qumështi dhe taksës për krem qumështi.

Propozimi i projektligjit “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”

Në nenin 49 “Shkallët e reduktuara”, shtohet pika 10:
10. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e inputeve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuar në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, është 10 për qind. Këto inpute nuk i përkasin më normës së TVSH-së zero (Lista e mallrave të përjashtuara nga TVSH-ja në nenin 51).

Në nenin 56 “Përjashtime të veçanta në import”: Importimi i makinerive dhe pajisjeve në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë (nga 50 milionë lekë që ishte më parë) bën përjashtim të vecantë. Gjithashtu, importimi i makinerive prodhuese nga subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin shfuqizohet nga lista e përjashtimeve të veçanta në import.

Në nenin 148 “Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor”, vlera e normës së kompensimit të prodhuesit bujqësor nga 6 përqind bëhet 0 përqind.

Proposal of the draft law “On an amendment to law no. 8438, dated 28.12.1998 ‘On Income Tax’, amended”.

Table no. 1, “Table of personal income tax from employment”, attached to the law, is replaced with the table below:

“Table on personal income tax from employment”

Monthly personal income from employment (in ALL)		Taxable income in (in ALL/ month)		Tax rate in % per month (PIT rate)
From	Up to	From	Up to	
0	40 000	0	40 000	0%
40 001	50 000	0	30 000	0%
		30 001	50 000	50% * 13% of the amount exceeding 30 000 ALL
50 001	Above	0	30 000	0%
		30 001	200 000	13% of the amount exceeding 30 000
		200 001	Above/ Higher	22 100 ALL+ 23% of the amount exceeding 200 000

This law enters into force 15 days after its publication in the OG and extends its effects starting from July 1, 2022.

Proposal of the draft law “On some additions and amendments to law no. 61/2012, ‘On Excises in the Republic of Albania’, amended”

Excise calculated in the unit of measurement according to the respective sections is indexed every two years based on the announced inflation rate for the previous two years, with the exception of tobacco and its by-products. In 2022, excise is indexed with the announced inflation rate of 2020 plus the resulting declared inflation rate by the end of the 9 months of 2021.

To supervise the stamping process, the authorized operators should take measures to ensure surveillance by placing cameras, presenting reconciliations for each stamping process, and giving prior notice 3 days before the process takes place. In any case it deems reasonable, the competent customs authority may ensure its presence to oversee the process.

Surpluses or deficits in fiscal stamps inventory, found during the control of fiscal warehouses, constitute administrative contraventions and are punished with a fine from 20,000 to 50,000 ALL.

Propozimi i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar”.

Tabela nr. 1, “Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi”, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohet me tabelen më poshtë:

“Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi”

E ardhura nga paga në lekë/muaj		E ardhura e tatueshme në lekë/muaj		Norma Tatimore në përqindje/mujore
Nga	Deri në	Nga	Deri në	
0	40 000	0	40 000	0%
40 001	50 000	0	30 000	0%
		30 001	50 000	50% * 13% të shumës mbi 30 000 lekë
50 001	Më tepër	0	30 000	0%
		30 001	200 000	13% e shumës mbi 30 000 lekë
		200 001	Më tepër	22 100 lekë + 23% të shumës mbi 200 000 lekë

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare dhe i shtrin efektet duke filluar nga data 1 korrik 2022.

Propozimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”

Akciza e llogaritur në njësinë matëse sipas seksioneve respektive, indeksohet çdo dy vjet bazuar në normën e shpallur të inflacionit për dy vitet paraardhëse, me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve të tij. Në vitin 2022, akciza indeksohet me normën e shpallur të inflacionit të vitit 2020 plus normën e rezultuar të shpallur të inflacionit deri në fund të 9 mujorit të vitit 2021.

Për mbikqyrjen e procesit të vendosjes së pullave, operatorë e autorizuar duhet të marrin masa për të siguruar mbikqyrje nëpërmjet vendosjes së kamerave, paraqitjes së rakordimeve për çdo proces pullosje, si dhe njoftimit paraprak 3 ditë përpara zhvillimit të procesit. Autoriteti doganor kompetent mund të sigurojë prezencën e tij për mbikëqyrje.

Tepricat ose mangësitë në pulla fiskale, të konstatuara gjatë kontrollit të magazinave fiskale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë nga 20.000 lekë deri në 50.000 lekë.

Violation of the obligation to keep records of accounting and differences, or failure to provide records at the request of customs authorities results in a fine in the amount of 50,000 ALL (previously 500,000 ALL).

Surpluses or deficits in fiscal stamps inventory over 2% of the accounting amount calculated for the period under control, ascertained during the control of economic operators who are not approved depositors, constitute administrative contraventions and are punishable by a fine according to the Customs Code of the Republic of Albania.

The decision of the competent customs authorities for the payment of the excise duty and / or the relevant sanctions, defined in this law, must be taken within 60 days (changed from 10 days) from the date of written notification of the minutes of the violation

The General Director of Customs takes a decision within 60 days (change made here, previously 30 days) from the date of receipt of the complaint and this decision is immediately notified to the appellant and the competent customs authorities.

Against the decision of the General Director of Customs, the appellant may appeal to the judicial authorities within 45 days from the date of notification of the non-receipt of the complaint (from 30 days ago), or within 45 days from the end of the appeal review period.

Ratification of the convention, between the Council of Ministers of the Republic of Albania and the Government of the State of Israel, for the avoidance of double taxation and the prevention of fiscal evasion related to income tax.

This bill under consideration is to be approved and will result in the concluded ratification of the convention between the two countries, in order to avoid double taxation and prevent fiscal evasion.

After ratification by the Parliament, this Agreement enters into force and becomes effective from 1 January of the following year, as provided in Article 28 of the Agreement.

Shkelja e detyrimit për mbajtjen e regjistrave, të kontabilitetit dhe diferencat ose mosdhënia e regjistrimeve, sipas kërkesës së organeve doganore, dënohet me gjobë në masën 50,000 lekë (më parë 500.000 lekë).

Tepriat ose mangësitë në pullat fiskale mbi 2 % të sasisë kontabël të llogaritur për periudhën objekt kontrolli, të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomikë të cilët nuk janë depozitues të miratuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë sipas Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

Vendimi i autoriteteve doganore kompetente për pagimin e detyrimit të akcizës dhe/ose të sanksioneve përkatëse, të përcaktuara në këtë ligj, duhet të merret brenda 60 ditëve (ndryshuar nga 10 ditë që ishte më parë) nga data e njoftimit me shkrim të procesverbalit të konstatimit të shkeljes.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankesës (nga 30 ditë që ishte më parë) dhe ky vendim u njoftohet menjëherë apeluesit dhe autoriteteve doganore kompetente.

Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, apeluesi mund të ankohet pranë autoriteteve gjyqësore brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të mospranimit të ankesës (nga 30 ditë që ishte më parë), ose brenda 45 ditëve nga mbarimi i afatit të shqyrtimit të ankimit.

Ratifikimi i konventës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së shtetit të Izraelit, për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat.

Ky projektligj është në shqyrtim për t'u aprovuar dhe synon të ratifikojë konventën ndërmjet dy shteteve, për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal.

Pas ratifikimit nga Kuvendi, kjo Marreveshje, hyn në fuqi dhe ka efekt nga 1 janari i vitit pasardhës, sic parashikohet në nenin 28 të Marreveshjes.

Proposal of the draft law "Some changes and additions to the law no. 9917, dated 19.5.2008, 'On the prevention of money laundering and terrorist financing', amended"

In Article 3 "Entities subject to the law" the following are added:

- Any individual, natural or legal person, who trades goods or services to the extent that he makes or accepts payments in physical money in the amount of 1,000,000 ALL or more.
- Statutory auditors, certified public accountants, tax advisors, and any other person undertaking to provide assistance and advisory on any taxation matter, as a core business or other professional activity".
- The case when the real estate agents operate as intermediaries in the rental of the real estate, in relation to the payments for which the monthly rent reaches the value of 500 000 (five hundred thousand) ALL or more.

The data, information and documentation collected as required by the laws are stored for a period of 5 years from the data of the termination of the business relationship between the client and the subject, but not more than 40 (forty) years from the data of each of them or the date of collection of documentation or analysis.

The General Directorate for the Prevention of Money Laundering, as a unit of financial intelligence, may refuse the exchange of information with foreign counterpart agencies only in exceptional circumstances when the exchange is deemed to be contrary to the basic principles of Albanian legislation. It may also reject requests for information from law enforcement agencies when the provision of information violates an investigation or analysis initiated, or is clearly disproportionate to the legitimate interests of a person or unrelated to the purpose for which the request was made.

Law enforcement agencies inform the General Directorate of Money Laundering Prevention about the use of information or data submitted mainly by the latter, as well as the results of investigations or based inspections, periodically every 6 months.

Lawyers are exempted from the obligation to report, on the data they have learned through the person protected or represented by them, in a court process, or from the documents that the latter has made available to them, in the function of the required protection.

Propozimi i projektligjit "Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, 'Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit', i ndryshuar"

Në Nenin 3 "Subjektet që i nënshtrohen këtij ligji" shtohen:

- Secili individ, person fizik apo juridik, që tregton mallra apo shërbime në masën që kryen apo pranon pagesa në para fizike në një shumë prej 1 000 000 (një milion) lekësh ose më shumë.
- Audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar, këshilltarët tatimorë, si dhe çdo person tjetër që merr përsipër të ofrojë ndihmë materiale, asistencë apo këshillim për çështje tatimore, si biznes kryesor apo veprimtari profesionale."
- Rasti kur agjentët e pasurive të paluajtshme veprojnë si ndërmjetës në dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, në lidhje me transaksionet për të cilat qiraja mujore arrin në vlerën e barabartë apo më të madhe se 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

Të dhënat, informacioni dhe dokumentacioni i mbledhur në zbatim të ligjit ruhen për një periudhë 5-vjeçare nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit, por jo më shumë se 40 (dyzet) vite nga data e secilit transaksion apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo kryerjes së analizës.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, si njësi e inteligjencës financiare mund të refuzojë shkëmbimin e informacionit me agjencitë homologe të huaja vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur shkëmbimi vlerësohet se është në kundërshtim me parimet themelore të legjislacionit shqiptar. Gjithashtu, mund të refuzojë kërkesat për informacion nga organet ligjzbatuese kur dhënia e informacionit cenon një hetim apo analizë të nisur, ose është qartazi jo në proporcion me interesat e ligjshme të një personi apo pa lidhje me qëllimin për të cilin është bërë kërkesa."

Organet ligjzbatuese informojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për përdorimin e informacionit apo të dhënave, si dhe për rezultatet e hetimeve apo të inspektimeve të bazuara, në mënyrë periodike çdo 6 muaj.

Avokatët përjashtohen nga detyrimi për raportim, për të dhënat që i kanë mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tyre, në një proces gjyqësor, ose nga dokumentet, që ky i fundit ua ka vënë në dispozicion, në funksion të mbrojtjes së kërkuar.

For the cases when the violations of the obligations provided in this law and in the bylaws in its implementation are serious, repeated, or systematic, the maximum fine is imposed on the subjects in at least twice the amount of the benefit derived from the violation (when that benefit can be determined) or up to 125 000 000 ALL in cases when it can not be determined or is smaller.

When the entity is a legal entity, a fine of up to 10 percent of the total annual turnover is imposed according to the consolidated financial statements of the last year. In case 10 (ten)-the percentage (equal to 10 (ten)) of the total annual turnover is less than 625 000 000 ALL, the responsible authority imposes a fine up to 625 000 000 ALL.

When the subject is a natural person, a fine of up to 625,000,000 ALL is imposed.

Reference: [link](#)

Për rastet kur shkeljet e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij janë të rënda, të përsëritura, apo sistematike, ndaj subjekteve vendoset gjoba maksimale në së paku dyfishin e shumës së përfitimit të nxjerrë nga shkelja (kur ai përfitim mund të përcaktohet) ose deri në 125 000 000 lekë në rastet kur nuk mund të përcaktohet apo është më i vogël.

Kur subjekti është person juridik, vendoset gjobë deri në 10 përqindëshin e qarkullimit total vjetor sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit të fundit. Në rast se 10 (dhjetë)- përqindëshi i qarkullimit total vjetor është më pak se 625 000 000 lekë, nga autoriteti përgjegjës vendoset gjoba deri në 625 000 000 lekë.

Kur subjekti është person fizik vendoset gjoba deri në 625.000.000 lekë.

Referenca: [link](#)



Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al

